



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. Prot.

Vlorë, më 20.04.2017

Vendim
Nr. 51, datë 20.04.2017

PËR
MIRATIMIN E PYETËSORIT PËR STUDENTËT PËR VLERËSIMIN E
PROGRAMEVE MËSIMORE TË HARTUARA NGA PERSONELI AKADEMIK
I UV-SË SIPAS FAKULTETEVE

Mbështetur në shkronjat **j** dhe **k** të pikës **1** në nenit **38** të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 20.04.2017

VENDOSI:

1. Të miratojë pyetësin (këtu bashkëlidhur) për studentët për vlerësimin e programeve mësimore të hartuara nga personeli akademik i UV-së sipas fakulteteve.
2. Vendimi regjistrohet dhe arkivohet.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

PYETËSOR PËR VLERËSIMIN E PROGRAMEVE MËSIMORE

EMRI I FAKULTETIT

SEZONI: _____

VITI I STUDIMIT: _____

PROGRAMI MËSIMOR: _____

DEPARTAMENTI: _____

I NDERUAR STUDENT!

Ky është një pyetësor që bëhet për të vlerësuar programin mësimor që jeni duke ndjekur/përfunduar së ndjekuri.

Me këtë pyetësor nuk vlerësohen pedagogët. Vlerësohet përmbajtja e lëndëve që ju bëni dhe sa ju shërbejnë ato për t'u formuar në profesionin e ardhshëm.

Nuk duhet të shënoni emrin në këtë pyetësor.

Përgjigjet tuaja do të mbeten anonime dhe askush nuk do të mund t'ju identifikojë.

Ju lutem, sigurohuni që i keni lexuar të gjitha pyetjet dhe PËRGJIGJUNI ME SINQERITET!

Vendosni X tek kutia e përgjigjes që mendoni më të drejtë.

		Aspak dakord	Pjesërisht dakord	Plotësisht dakord	Nuk e di
1.	A i përshtatet programi teorik i ofruar (temat e leksioneve) formimit tuaj profesional?				
2.	Mendoni se temat mësimore të ofruara nga programi mësimor kanë rritur ndjeshëm njohuritë e tua?				
3.	Mendoni se temat mësimore të ofruara nga programi mësimor do t'ju hyjnë në punë gjatë ushtrimit të profesionit?				



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

4.	Mendoni se orët e praktikës mësimore janë të mjaftueshme?				
5.	Mendoni se orët e praktikës profesionale janë të mjaftueshme?				
6.	Mendoni se orët e laboratorëve janë të mjaftueshme për praktikimin e teknikave të profesionit që ju do ushtroni?				
7.	Mendoni se orët e seminareve janë të mjaftueshme për diskutimin e plotë të njohurive të marra në leksione?				
8.	Mendoni se librat e përdorur janë të mjaftueshëm (të standardeve bashkëkohore) për të përvetësuar njohuritë?				
9.	Mendoj se pas diplomimit në këtë program studimi do të kem mundësi të larta punësimi (brenda apo jashtë vendit)				
10.	Çfarë modulesh mendoni se do ju duhen më shumë kur të ushtroni profesionin?				
11.	Shkruani opinionin tuaj për lëndët me zgjedhje:				
12.	Shkruani opinionin tuaj për lëndët e detyruara:				



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SENATI AKADEMIK

13.	Çfarë mendoni se mund të bëhet më shumë gjatë orëve të leksioneve?
14.	Çfarë mendoni se mund të bëhet më shumë gjatë orëve të seminareve?
15.	Çfarë mendoni se mund të bëhet më shumë gjatë orëve të laboratorit?
16.	Çfarë mendoni se duhet të ndryshojë në programin mësimor që po ndiqni?
17.	Shkruani sugjerimet tuaja, nëse i mendoni të nevojshme: